



LËNDA MORFOLOGJI - LEKSIONI 5

Tema: Llojet e temave

Çështjet që do të trajtohen:

- Klasifikimi i llojit të temave

Tema e fjalës

Tema e fjalës është pjesa e fjalës që mbetet si të hiqen mbaresa dhe prapashtesa trajtëformuese kur ka të tilla *det-i, shok-u*

Te pjesët e pandryshueshme të ligjëratës tema përkon me vetë fjalën: *mirë, keq*

Tema mund të jetë e parme ose jo e parme

Temat e parme janë të pazbërthueshme morfologjikisht dhe të pamotivueshme semantikisht. Ato përbëhen vetëm prej një morfeme, pra përputhen me rrënjën e fjalës.

Shembull: *shok, lis, pëllumb*

Temat jo të parme janë të zbërthueshme morfologjikisht dhe të zbërthueshme semantikisht. Ato paraqiten si tërësi të përbëra nga bashkime të ndryshme morfemash, rrënjësh, parashtesash dhe prapashtesash.

Shembull: *qytetar - qytet, i zjarrtë – zjarr.*

Për të gjetur temën, nga përbërja e fjalës duhen veçuar vetëm ndajshitesat trajtëformuese.

Tema fjalëformuese: quhet tema prej së cilës është formuar në të vërtetë ose ndihet si e formuar një temë jo e parme. Nga tema e parme e emrit *besë* është formuar mbiemri *besnik*. Për të tema *besë* është temë fjalëformuese prej së cilës është formuar me anë të prapashtesës – *nik* tema jo e parme *besnik*.

Analiza morfemore dhe analiza fjalëformuese.

Analiza morfemore, bëhet zbërthimi i fjalës në rrënjë, parashtesa, prapashtesa dhe mbaresa. Së pari veçohet mbaresa, pastaj përcaktohet karakteri i temës, nëse tema është jo e parme, gjendet tema fjalëformuese dhe me anë të krahasimit veçohen ndajshtesat fjalëformuese. Por kjo analizë mund të bëhet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Shembull: *paftësi* temë jo e parme, tema fjalëformuese *ftësi* – ndajshtesa *pa*, *ftësi* temë jo e parme, tema e parme *i ftë* ndajshtesa *si*: *i ftë* temë e parme, rrënja e fjalës.

Analiza fjalëformuese ka detyrë të zbulojë mënyrën e bashkimit të morfemave që përbëjnë një fjalë me temë jo të parme, që të sqarojë sistemin e lidhjeve dhe të marrëdhënieve që kanë ato midis tyre.

Në analizën e fjalës nga pikëpamja e formimit të saj në radhë të parë përcaktohet tema ose temat fjalëformuese.

Shembull: *pakënaqësi* ka si temë fjalëformuese *kënaqësi* dhe është formuar me anë të parashtesës *pa*, pra me parashtesim.

Pagjumësi – ka si temë fjalëformuese *gjumë* dhe është formuar me prapashtesën *si*, pra me prapashtesim të një togu parafjalor *pagjumë*

Pafundësi – ka si temë fjalëformuese mbiemrin *i pafund* dhe është formuar me prapashtesim (*ë*) *si*

Pra këtu kishim tri fjalë të ngjashme nga ndërtimi, por të ndryshme nga formimi.

Burimi: <http://www.ikub.al>